




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



22-01-2021

Prishtinë / Pristina

241-2021



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 neni 25 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6.3 dhe neni 7.1 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 Çertifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre dhe neni 3 të Rregullës Zgjedhore 15/2013 Zgjedhjet e Parakohshme, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 22/01/2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e **40** kandidatëve të subjektit politik **Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI** për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- II. Zyra obligohet që të njoftoj subjektin politik, **Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI**, për marrjen e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Subjekti politik **Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI** ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik dhe kandidatëve të saj me datë 16 janar 2021. Pas kontrollimit të dokumentacionit, me datë 17 janar 2021, Zyra ka dorëzuar shkresë në adresë të subjektit politik për përmirësim të dokumentacionit. Pas kësaj, subjekti politik ka dorëzuar në Zyrë përmirësimet e nevojshme brenda afatit.

Në kuadër të obligimeve ligjore dhe konform aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. KO95/20, datë 6 janar 2021 dhe obligimeve të cilat rrjedhin nga ky aktgjykim për KQZ-në si dhe duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja nëpërmjet Zyrës ka kërkuar nga institucionet relevante verifikimin e kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nëse janë në përputhje me kërkesat nga neni 29 i këtij ligji. Në mes të institucioneve të tjera, KQZ ka kërkuar edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës verifikimin e kandidatëve për të gjitha subjektet politike të cilat kanë aplikuar për certifikim. Me datë 20 janar, KQZ-ja ka pranuar shkresën nga ky institucion dhe në këtë shkresë është cekur se 4 persona të cilët janë kandidatë të listës së subjektit politik **Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI** kanë vendime të plotëfuqishme për vepër penale nga gjykata në tri vitet e fundit.

Zyra, me datë 20 janar 2021, nëpërmjet e-mailit zyrtar ka njoftuar subjektin politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim- PAI se 4 kandidatët nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht germën q të këtij neni që specifikon se kandidat nuk mund të jetë një person i cili është q) i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit dhe i është kërkuar që të zëvendësojë 4 kandidatët (lista e të cilëve do t'i bashkangjitet këtij vendimi) me kandidatë të gjinisë së njëjtë deri më 21 janar në orën 13:00.

Meqenëse subjekti politik deri në afatin e përcaktuar nuk ka sjellur zëvendësimet e kërkuara me kandidatë që i plotësojnë kriteret e kërkuara me ligj, KQZ në mbledhjen e datës 22 janar 2021 me shumicë votash nuk e certifikoi subjektin politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI dhe as listën e kandidatëve të saj.

Anëtarët e KQZ-së janë deklaruar në mbledhje se janë të gatshëm të certifikojnë edhe subjektin politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim – PAI dhe kandidatët që i kanë përmbushur kriteret ligjore, tashmë të verifikuara, mirëpo përfaqësuesi i këtij subjekti politik në KQZ, ka insistuar që të votohet lista e plotë, përfshirë edhe kandidatët që nuk janë në përputhshmëri me nenin 29, germën q, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Andaj, ashtu siç u tha më lartë, KQZ-ja refuzoi rekomandimin e Zyrës sepse lista e kandidatëve e cila ishte rekomanduar nga Zyra ishte në kundërshtim të plotë me nenin 29, germën q, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Valdete Daka



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë – PZAP.

1. Qazim Rahmani, i Denuar me Aktgjykim të Plotfuqishem PKR 333/2017 të dates: 09.11.2018, dhe P-140/2016 të datës 27.04.2018
2. Florim Bajrami, i Denuar me Aktgjykim të Plotfuqishem P-1564/2017 të dates: 26.01.2018
3. Fadil Podrimja, i Denuar me Aktgjykim të Plotfuqishem P-205/2018 të dates: 13.12.2018
4. Agon Asllani, i Denuar me Aktgjykim të Plotfuqishem P 3814/2016 të dates: 22.01.2018



PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI

Nr	Emri/Ime	Mbiemri/Prezime	Gj/P
1	QAZIM	RAHMANI	M
2	BEKIM	ARIFI	M
3	NASIBE	BAJRAMI	F/Ž
4	RESUL	MAKRESHI	M
5	EGZONIT	JAKUPI	M
6	PAKIZE	BUJANI	F/Ž
7	ASLAN	KRUEZI	M
8	GANI	ELSHANI	M
9	ELMEDINA	BAJRAMI	F/Ž
10	LAVDIM	BAJRAMI	M
11	FLORIM	BAJRAMI	M
12	TUANETA	REXHA	F/Ž
13	FADIL	PODRIMJA	M
14	NUHI	BAJRAMI	M
15	ARTA	XHELA	F/Ž
16	NEXHMEDIN	SHABANAJ	M
17	EMRAN	ADIQI	M
18	FATIME	OSMANI	F/Ž
19	BAJRAM	SEJDIU	M
20	IDRIZ	BERISHA	M
21	ELVAN	GALUSHI ELSHANI	F/Ž
22	ALI	ADEMI	M
23	AGRON	ZENUNAJ	M
24	XHULSUME	ADEMI	F/Ž
25	AGON	ASLLANI	M
26	IBRAHIM	KADRI	M
27	GONE	SINANAJ	F/Ž
28	HABIB	GASHI	M
29	JETON	MEKOLLI	M
30	VALBONE	KRYEZIU	F/Ž
31	ISUF	DUBOVA	M
32	ALI	GORANI	M
33	MEJREME	BERISHA	F/Ž
34	AHMET	PODRIMJA	M
35	ZABID	MUSTAFA	M
36	REMZIJE	ARIFI	F/Ž
37	MURSEL	GASHI	M
38	DRITON	HAFIZALLAR	M
39	NEBAHATE	KURTESHI	F/Ž
40	MUSA	SINANAJ	M